



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

### GJYKATA KOMERCIALE

---

**KA 166/24**

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga Korab Bokshi avokat nga Gjakova Rr. Tirana nr.40 kati i tretë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për anulim të vendimit të 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024 me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit jashtë seancës, lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës, më datë 23.04.2024 merr këtë:

#### **A K T V E N D I M**

Hedhet poshtë Padia dhe Propozimi i paditësit Paditësit "G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë me propozim për shtyrje të vendimit të 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024, si e pa pranueshme.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 03.04.2023, në këtë Gjykatë në Departamentin Administrativ paditësi "G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë, i përfaqësuar nga Korab Bokshi avokat nga Gjakova ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për anulim të vendimit të 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024 me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit jashtë seancës.

Me aktvendim të datës 05.04.2024 paditësi i është kthyer plotësimi padia dhe propozimi, ndërsa me datë 22.04.2024 është kthyer në gjykatë e plotësuar me pagesë të taksës për padi, taksës për propozim, me autorizim të përfaqësuesit si dhe me certifikate të regjistrimit të biznesit.

Paditësi në Kërkese për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të Komunës së Gjakovës 01.r.070/01-2942 dt. 27.02.2024 konsideron se janë plotësuar kushtet konform nenit 22 par.6 të Ligjit për Konfliktet Administrative (tutje LKA), lidhur me nenin 63 të LKA-së dhe nenit 297.1 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje i referohem si LPK), me arsyetim se:

Komuna e Gjakovës përmes njoftimit për Ankand Publik nr. 01-96302 -1251 dt. 29.01.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vit të pronës së paluajtshme komunale me nr. të parcelës P-70705029- 016371-1 ka hapur ankand publik lidhur me paluajtshmërinë. Me dt. 15.02.2024, ka shpallur Njoftimin me nr. 01-463/01-2278 për fituesin e Njoftimit Publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nënte (99) vite të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P- 70705029-016371-1.

Përfaqësuesi i paditësit deklaron se janë plotësuar komulativisht kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) të LPK-së, në ndërlidhje me nenin 63 LKA-së.

Sa i përket kushtit të parë, pala paditëse ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive, e cila është e parapara me nenin 297.1 par. a) të LPK-së, deklaron se Subjektet juridike [N.T.SH.](#) "G.B.-Construction" me seli në Gjakovë dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli në Gjakovë në bashkëpunim në formë të koncesionit kanë aplikuar për marrjen në shfrytëzim dhe ndërtim në parcelën lëndore sipas Njoftimit Publik 01Nr.463/02-11062 të dt. 05.05.2021, të Komunës së Gjakovës për marrjen në shfrytëzim për 99 vite njësinë kadastrale 1637/1 ZK Gjakovë Qytet në sipërfaqe prej 0.0356 ha, në pronësi P.SH. Komuna e Gjakovës.

Përkundër faktit se subjekti juridik ka përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në Njoftimin Publik të dt. 05.05.2021, përmes Ëeb -Faqes së Komunës së Gjakovës, me Njoftimin Publik 01.nr.463/02-7838 të dt. 29.03.2022, kanë kuptuar se nuk i është dhënë në shfrytëzim paluajtshmeria lëndore me arsyetimin se kinse "Aplikuesit GB. Construction i mungon Dëshmia që vërteton se ofruesi mund të realizoj projektin sipas kushteve ndërtimore të paraqitura në njoftim publik". Lidhur me këtë proces për të njëjtën paluajtshmëri është iniciuar kontest

gjqësor, i cili ne Gjykatën Komerciale të Kosovës evidencohet si KA.nr.1166/22. E njëjta paluajtshmeri në Njoftimin për Ankand Publike nr. 01-96302 -1251 dt. 29.01.2024 i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vit te pronës se paluajtshme komunale me nr. te parceles P- ... duke njohur si fitues një subjekte te trete.

Ndërsa sa i përket kushtit te dyte ligjor te parapare me nenin 297.1 par b) te LPK-se konsideron se pa nxjerrjen e vendimit për shtyrje te ekzekutimit te vendimit te atakuar me padi palës paditëse do te i shkaktohet dem i madh dhe i pariparueshëm dhe do t'i pamundësohet realizimi i kërkesës sepse bëhet fjalë për te njëjtën paluajtshmeri per te cilen eshte hapur konflikti administrativ KA.nr.1166/22, prandaj i propozon gjykatës që ta aprovoj propozimi i propozuesve/paditësve [N.T.SH.](#) "G.B. - CONSTRUCTION" me seli ne Gjakove dhe "YLLI PASHTRIKU" sh.p.k. me seli ne Gjakove, të shtyhet ekzekutimi i Vendimit te Komunës se Gjakovës 01 nr.070/01-2942 dt. 27.02.2024 me te cilin është vendosur qe te refuzohet si e pabazuar ankesa e "G.B. Construction" dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me nr. 01-070/01-2536 e dt.21.02.2024, deri në vendim përfundimtar lidhur me padinë.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata shqyrtoj pranueshmërinë e padisë dhe të propozimit në kuptim të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) neni 9 ku përcaktohet se *Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative* dhe Neni 10 1. *Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.*

Gjykata vlerëson se paditësi nuk është palë me interes në vendimin e kundërshtuar sepse i njejt nuk është as pjesëmarrës në Ankandin Publik nr. 01-96302 -1251 dt. 29.01.2024 në bazë të cilit i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vit te pronës se paluajtshme komunale me nr. te parceles P- ... subjekte te trete.

Gjykata vlerëson se të gjitha pretendimet e paditësit i referohen pjesëmarrjes se tij Njoftimin Publik 01Nr.463/02-11062 te dt. 05.05.2021, të Komunës së Gjakovës për marrjen ne shfrytëzim për 99 vite njësinë kadastrale 1637/1 ZK Gjakove Qytet në sipërfaqe prej 0.0356 ha, ne pronësi P.SH. Komuna e Gjakovës, me pretendim se Subjektet juridike N.T.SH. "G.B.-Construction" me seli ne Gjakove dhe "Ylli Pashtriku" sh.p.k. me seli ne Gjakove ne bashkëpunim ne forme te koncesionit kanë aplikuar për marrjen ne shfrytëzim dhe ndërtim në parcelën lëndore, mirëpo deklararon se përkundër faktit se subjekti juridik ka përmbushur te gjitha kushtet e përcaktuara ne Njoftimin Publik te dt. 05.05.2021, përmes Ëeb -Faqes së Komunës se Gjakoves, me Njoftimin Publik 01.nr.463/02-7838 të dt. 29.03.2022, kanë kuptuar se nuk i është dhëne ne shfrytëzim paluajtshmeria lëndore me arsyetimin se kinse "Aplikuesit GB. Construction i mungon Dëshmia qe vërteton se ofruesi mund te realizoj projektin sipas kushteve ndërtimore të paraqitura në njoftim publik".

Gjykata vlerëson se i njëjti lidhur e këtë procedurë ka iniciuar konflikt administrativ ne Gjykatën Komerciale të Kosovës evidentohet si KA.nr.1166/22, dhe i njëjti ka parashtruar edhe Kërkesë për shtyrje të ekzekutimit te aktit administrativ të kundërshtuar e cila i është hedhur si e papranueshme.

Prandaj pretendimet lidhur me ligjshmërinë e iniciuar të aktit administrativ në lëndën KA.nr.1166/22, janë objekt i padisë në këtë çështje administrative, ndërsa sa i përket vendimit të kundërshtuar paditësi nuk ka dëshmuar se ka interes juridik në vendimin e kundërshtuar më të cilin ka përfunduar procedura e Ankandit Publike nr. 01-96302 -1251 dt. 29.01.2024 për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vit te pronës se paluajtshme komunale me nr. te parceles P- ... sepse i njëjti nuk ka marrë pjesë në këtë procedurë.

Prandaj, në kuptim të Nenit 34 të LKA-së ku përcaktohet: 1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.3. është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj, hedhet poshtë padia dhe propozimi për masë si i papranueshëm.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.166/24, datë 23.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.